



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 294, datë 17.12.2020

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR 1  
(NJË) POZICION PRANË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËRMES  
PROCEDURËS SË KOMANDIMIT TË PROKURORËVE**

Në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 166 pika 2, 184, 189 pika 1, gërma "b", të Ligjit 115 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, nenet 53, pika 2 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

**V E N D O S I:**

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 1 (një) pozicioni pranë Ministrisë së Drejtësisë si Përgjegjës i Sektorit të së Drejtës Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, përmes procedurës së komandimit.
2. Afati i komandimit do të jetë 2 vjet (dy vjet).
3. Ftohen të gjithë prokurorët që përmbushin kushtet e mëposhtme të shprehin interesin për t'u komanduar:
  - të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
  - të ketë ushtruar profesionin e magjistratit për të paktën 3 vite;
  - përvoja në hartim aktesh si dhe në pozicione drejtuese, në rast se ka, do të vlerësohet pozitivisht;
  - të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet Anglishtja);
  - të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
  - të ketë aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi, si dhe për të punuar në grup;
  - të ketë njohuri baze në përdorimin e kompjuterit.
4. Shprehja e interesit duhet të paraqitet jo më vonë se 2(dy javë) nga Njoftimi për shprehjen e interesit në faqen zyrtare të Këshillit dhe të dorëzohet në adresën: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Ana Komnena", Godina "Poli i Drejtësisë", Tiranë.** Mbi zarf duhet të shënohet "Shprehje interesi për komandim pranë Ministrisë së Drejtësisë". Shprehja e interesit duhet të përmbajë: Letrën e motivimit ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy

faqe A4) një CV të përditësuar, dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj dhe çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga kandidati.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KRYETARI**

**GENT IBRAHIMI**

